



Data: 29/07/2019

Ref.: 1378/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Gjuhë dhe letërsi frenge, MA 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Gjuhë dhe Letërsi turke, MA 60 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik;
 - Orientalistikë: Studime kulturore orientale, MA 60 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik;
 - Gazetari dhe marrëdhënie me publikun, MA 120 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
- II. Obligohet Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Filologjisë ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetin e Filologjisë më datë 28.05.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Thomas Bauer, Prof. Dr. Barbara Kerovec, Prof. Dr. Vjeran Kursar dhe Prof. Dr. Anida Kisi.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Filologjisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raportet e ekspertëve ndërkombëtar konstatojnë se programet e studimit Gjuhë dhe letërsi frenge (MA), Gjuhë dhe letërsi turke (MA), Orientalistikë: Studime kulturore orientale (MA) dhe Gazetari dhe marrëdhënie me publikun (MA) të ofruara nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Filologjisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

